

Vendim nr. 268 datë 11.11.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj, Kryetare
Marjana Semini, Anëtare
Marsida Xhaferllari, Anëtare

në datën 11.11.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 8 (R) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: ROLAND BICI

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-4640, datë 09.11.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 17, pika 2, 18, pika 1, 33, pika 1, 42, pika 2, 107, pika 3, 131, pika 1, shkronja “f”, 134 dhe 142, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6, pika 1 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Roland Bici ka qenë i punësuar në Ministrinë e Mbrojtjes në pozicionin “specialist-jurist” në Sektorin e Prokurimeve Civile dhe në vitin 2012 ka fituar statusin e

Nëpunësit Civil. Departamenti i Administratës Publike (DAP) në datën 26.12.2013 ka miratuar propozimin e Ministrisë së Mbrojtjes për kalimin e kërkuarit në listën e pritjes për shkak ristrukturimi. Ky kalim i është njoftuar kërkuarit nga sekretari i përgjithshëm i kësaj ministrie në datën 08.01.2014.

2. Në datën 12.02.2024 kërkuari është ankuar pranë Komisionit të Shërbimit Civil (KSHC). Ky i fundit, në datën 13.02.2014, ia ka kthyer ankesën kërkuarit, me arsyetimin se i mungonte juridiksioni dhe kompetenca për shqyrtimin e ankesave të tilla, duke e orientuar atë t'i drejtohej gjykatës. Në vijim, në datën 06.03.2014, kërkuari ka ngritur padi në gjykatë, me objekt konstatimin e pavlefshmërisë absolute të akteve të kalimit në listëpritje të lëshuara nga DAP-i dhe Ministria e Mbrojtjes.

3. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 2805, datë 30.05.2014, ka vendosur rrëzimin e padisë, duke e zgjidhur mosmarrëveshjen bazuar në parashikimet e ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Për statusin e nëpunësit civil” (*Ligji i vjetër i Shërbimit Civil*). Ajo gjykatë ka arsyetuar se aktet e kundërshtuara nuk kanë elemente të pavlefshmërisë absolute.

4. Mbi bazën e ankimit të kërkuarit, vendimi është ndryshuar nga Gjykata Administrative e Apelit, e cila, me vendimin nr. 4471, datë 14.12.2016, ka vendosur pranimin e padisë. Sipas gjykatës së apelit, mosmarrëveshja duhej të ishte zgjidhur bazuar në ligjin nr.152, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil” (*Ligji i ri i Shërbimit Civil*) dhe se vendimi për kalimin e kërkuarit në listëpritje ishte marrë bazuar në një ligj të shfuqizuar.

5. Kundër vendimit kanë ushtruar rekurse Ministria e Mbrojtjes dhe DAP-i, të cilat kanë kërkuar edhe pezullimin e ekzekutimit të tij, ndërsa kërkuari ka paraqitur kundërrkurs. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, fillimisht, me vendimin nr. 78, datë 20.02.2017, ka vendosur mospranimin e kërkesës për pezullimin e vendimit, ndaj ai është ekzekutuar dhe kërkuari është rikthyer në një pozicion tjetër të ngjashëm në Ministrinë e Mbrojtjes.

6. Pas shqyrtimit të rekurseve dhe kundërrkursit, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2023-4640, datë 09.11.2023, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, me arsyetimin se mosmarrëveshja duhej të ishte zgjidhur sipas Ligjit të vjetër të Shërbimit Civil. Në ekzekutim të këtij vendimi, kërkuari është liruar sërish nga detyra me urdhrin nr.182, datë 15.07.2024 “Për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës së nëpunësit civil”.

7. Në datën 27.08.2024 kërkuari ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), sipas objektit të tij.

II

Pretendimet e kërkuetit

8. **Kërkueti**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar *e drejta për një proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

- 8.1. *E drejta e aksesit në gjykatë dhe e mbrojtjes efektive*, pasi Gjykata e Lartë ka vënë në diskutim, kryesisht, çështje të ligjit të zbatueshëm, duke mos i dhënë mundësinë kërkuetit për t'u mbrojtur efektivisht.
- 8.2. *E drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka konstatuar se Gjykata Administrative e Apelit nuk është investuar në shqyrtimin dhe analizën e shkaqeve ligjore të pretenduara nga palët për dhënien e vendimit të kalimit të tij në listëpritje.
- 8.3. *Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Lartë e ka identifikuar gabim ligjin e zbatueshëm. Data e paraqitjes së padisë është i vetmi argument i përdorur prej saj për ndryshimin e vendimit të gjykatës së apelit dhe rrëzimin e padisë, pa i dhënë përgjigje faktit se kërkueti kishte paraqitur ankim pranë KSHC-së përpara hyrjes në fuqi të vendimit të Gjykatës që ka shfuqizuar aktin normativ me fuqinë e ligjit.
- 8.4. *Parimi i sigurisë juridike*, pasi kërkueti ka pasur pritshmëri të ligjshme për vendimmarrjen e Gjykatës së Lartë, e cila, në raste analoge, ka mbajtur qëndrim të ndryshëm nga ai i mbajtur në çështjen objekt shqyrtimi.
- 8.5. *Parimi i barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit*, për shkak të qëndrimeve të ndryshme të mbajtura nga Gjykata e Lartë për çështje të ngjashme me atë të kërkuetit.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitetin e kërkuetit

9. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e

paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

10. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

11. Në lidhje me legjitimimin *ratione personae*, Kolegji vlerëson se kërkuesi, si individ, legjitimohet në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, sepse ka qenë palë në procesin gjyqësor, në të cilin është dhënë vendimi i kundërshtuar, ndaj justifikon interesin në çështjen e parashtruar.

12. Një kriter tjetër paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, sipas të cilit Gjykata bën gjykimin përfundimtar të ankesave individuale kundër çdo vendimi gjyqësor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese, që pretendohet se janë cenuar. Në rastin në shqyrtim, në ankimin kushtetues individual kërkuesi ka kundërshtuar vendimin e Gjykatës së Lartë, i cili ka përmyllur procesin gjyqësor të nisur prej tij. Në këtë situatë, Kolegji çmon se kërkuesi nuk ka më mjete të tjera ankimi ndaj vendimit të kundërshtuar, për rrjedhojë e ka përmbushur kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion.

13. Për sa i përket legjitimitimit *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Gjykata ka pohuar se kur ankimi ka të bëjë me vendimin e Gjykatës së Lartë, momenti i konstatimit të cenimit të së drejtës llogaritet data e marrjes dijeni të vendimit të arsyetuar, i cili, nëse palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit, duhet t’u njoftohet elektronikisht atyre (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në çështjen konkrete, vendimi i Gjykatës së Lartë mban datën 09.11.2024 dhe i është njoftuar avokatit të kërkuesit me postë elektronike në datën 30.04.2024, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 27.08.2024. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor.

15. Në drejtim të legjitimitimit *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar se vendimi i Gjykatës së Lartë, në shkelje të nenit 42 të Kushtetutës, është rrjedhojë e një procesi të parregullt ligjor, në drejtim të së drejtës së aksesit në gjykatë dhe mbrojtjes efektive, së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor,

si dhe parimeve të sigurisë juridike dhe barazisë përpara ligjit. Këto pretendime *prima facie* hyjnë në juridiksionin e Gjykatës, ndaj do të analizohen në vijim.

16. Lidhur me cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë dhe mbrojtjes efektive, kërkuesi ka parashtruar se Gjykata e Lartë me nismën e saj ka vënë në diskutim çështje të ligjit të zbatueshëm, për të cilat palët nuk kanë ngritur pretendime dhe, për rrjedhojë, ai nuk ka pasur mundësinë të mbrohet efektivisht. Lidhur me këtë pretendim, Kolegji vëren se në ndryshim nga sa pretendon kërkuesi, çështja e ligjit të zbatueshëm nuk është ngritur me nismën e Gjykatës së Lartë, por ka qenë një prej shkaqeve të ngritura nga Ministria e Mbrojtjes dhe DAP-i në aktet e rekursit. Kërkuesi është njoftuar rregullisht me aktet e rekursit dhe ka paraqitur edhe kundërrkurs. Po kështu, kërkuesi ka marrë njoftim rregullisht për seancën e dhomës së këshillimit të Gjykatës së Lartë ku do të shqyrtohej çështja e tij dhe nuk e ka shfrytëzuar mundësinë e paraqitjes së shpjegimeve dhe prapësimeve me shkrim. Në këto rrethana, Kolegji çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës së aksesit dhe mbrojtjes efektive në Gjykatën e Lartë, është haptazi i pabazuar.

17. Për sa i takon pretendimit për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, kërkuesi ka parashtruar se Gjykata e Lartë nuk ka konstatuar se Gjykata Administrative e Apelit nuk është investuar në analizimin e shkaqeve ligjore të pretenduara nga palët për daljen e vendimit administrativ për nxjerrjen e tij në listëpritje. Kolegji konstaton se argumenti i paraqitur nga kërkuesi është i pamjaftueshëm për të vënë në dyshim kompetencën dhe procedurën e ndjekur nga Gjykata e Lartë në shqyrtimin e çështjes, ndaj ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim.

18. Në lidhje me cenimin e *standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, sipas kërkuesit, Gjykata e Lartë e ka identifikuar gabim ligjin e zbatueshëm, duke përdorur si argument të vetëm datën e paraqitjes së padisë në gjykatën e shkallës së parë dhe duke mos mbajtur në konsideratë se ai kishte paraqitur ankim në KSHC përpara datës së hyrjes në fuqi të vendimit të Gjykatës, që ka shfuqizuar aktin normativ me fuqinë e ligjit dhe ky ankim i është kthyer për mungesë juridiksioni.

19. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 14, datë 21.03.2023; nr. 3, datë 20.01.2017; nr.38, datë 30.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, Gjykata ka theksuar se interpretimi i ligjit për qëllime të procesit gjyqësor është detyrë

e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, ndërsa detyra e Gjykatës është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese (*shih vendimet nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ajo ndërhyt atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimin nr. 30, datë 29.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Mbi bazën e standardeve kushtetuese të mësipërme, si dhe duke mbajtur në konsideratë argumentet e kërkuarit, Kolegji do të verifikojë nëse arsyetimi i vendimit të Gjykatës së Lartë ka përmbushur funksionin e një vendimi të drejtë nga pikëpamja e arsyetimit të ligjit të zbatueshëm dhe nëse ajo gjykatë ka dhënë arsytet se përse mosmarrëveshja zgjidhet sipas Ligjit të vjetër të Shërbimit Civil dhe cilat janë rrethanat faktike për të cilat zgjidhja e mosmarrëveshjes i nënshtrohet Ligjit të ri të Shërbimit Civil ose Ligjit të vjetër të Shërbimit Civil.

21. Nën këtë optikë, Kolegji vëren se Gjykata e Lartë ka parashtruar në arsyetimin e vendimit të saj se Ligji i ri i Shërbimit Civil është miratuar nga Kuvendi në datën 30.05.2013 dhe sipas nenit 72 të tij hynte në fuqi në datën 01.10.2013. Ligji në fjalë u ndryshua nga Këshilli i Ministrave me aktin normativ me fuqinë e ligjit nr. 5, datë 30.09.2013, i cili ka hyrë në fuqi menjëherë. Ndryshimet e miratuara shtynë efektet e Ligjit të ri të Shërbimit Civil pas 6 muajve, duke parashikuar se deri në datën e fillimit të efekteve do të zbatohet Ligji i vjetër i Shërbimit Civil. Gjithashtu, Gjykata e Lartë ka evidentuar se, ndërkohë, Gjykata, me vendimin nr. 5, datë 05.02.2014, ka shfuqizuar aktin normativ me fuqinë e ligjit, si të papajtueshëm me Kushtetutën, dhe vendimi i saj ka hyrë në fuqi në datën 26.02.2014, pas botimit në Fletoren Zyrtare nr. 18. Në vendimin e saj, Gjykata nuk është shprehur për efekte prapavepruese të vendimit të saj, ndaj sipas nenit 76 të ligjit nr. 8577/2000, vendimi ka fuqi prapavepruese vetëm ndaj çështjeve që shqyrtohen nga gjykatat, derisa vendimet e tyre nuk janë përfundimtare dhe të formës së prerë (*shih paragrafët 20-21 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Po kështu, sipas Gjykatës së Lartë, Kolegji Administrativ i saj ka mbajtur qëndrimin se shprehja në ligj “çështje që shqyrtohen nga gjykata, derisa vendimet e tyre nuk kanë marrë formë të prerë” duhet të kuptohet se përfshin tërësinë e çështjeve administrative që kanë qenë në shqyrtim në datën 26.02.2014, kur ka hyrë në fuqi vendimi i Gjykatës (*shih paragrafin 22, po aty*).

22. Mbi bazën e këtij interpretimi ligjor, Gjykata e Lartë ka evidentuar se, sipas fakteve të përcaktuara nga gjykatat e faktit, padia e kërkuarit ishte paraqitur në datën 06.03.2014, ndaj vendimi i Gjykatës nuk kishte efekte prapavepruese në rastin e tij dhe për këtë arsye zbatohet

Ligji i vjetër i Shërbimit Civil, siç kishte vlerësuar me të drejtë gjykata e shkallës së parë (*shih paragrafët 22-24, po aty*).

23. Në kuptim të sa më sipër, Kolegji çmon se në ndryshim nga sa pretendon kërkuesi, Gjykata e Lartë, në përputhje me kompetencat e saj, ka identifikuar ligjin e zbatueshëm dhe ka shpjeguar kuptimin e tij në këndvështrim të rrethanave konkrete të çështjes me qëllim zgjidhjen e mosmarrëveshjes konkrete. Gjykata e Lartë, në mënyrë të plotë dhe shteruese, ka parashtruar në vendimin e saj të gjitha argumentet mbi bazën e të cilave ka arritur në përfundimin e paraqitur në dispozitiv. Ajo, pasi ka marrë në shqyrtim përmbajtjen dhe procedurën për nxjerrjen e aktit të kundërshtuar, si dhe e ka analizuar atë në raport me dispozitat ligjore të zbatueshme, ka konkluduar me zgjidhjen në themel të padisë. Si konkluzion, vendimi i Gjykatës së Lartë, në tërësinë e tij, paraqitet pa gabime faktike dhe ligjore, duke përmbushur funksionin e një gjykimi të drejtë dhe respektuar standardet kushtetuese të arsytimit.

24. Për sa i takon pretendimit se Gjykata e Lartë nuk është shprehur lidhur me faktin se kërkuesi ka paraqitur ankim në KSHC përpara datës së hyrjes në fuqi të vendimit të Gjykatës dhe ky ankim i është kthyer për mungesë juridiksioni, rezulton se ky pretendim nuk ka qenë objekt shqyrtimi as në gjykatat e faktit dhe as në kundërrekursin e paraqitur përpara Gjykatës së Lartë. Kolegji evidenton se kjo e fundit nuk është gjykatë fakti, por gjykatë ligji që kontrollon vendimet e gjykatave më të ulëta vetëm në drejtim të zbatimit të ligjit material ose procedural.

25. Për sa më lart, Kolegji çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, është haptazi i pabazuar.

26. Për sa i takon pretendimit për cenimin e *parimeve të sigurisë juridike dhe të barazisë përpara ligjit*, kërkuesi ka parashtruar se ai ka pasur pritshmëri të ligjshme bazuar në çështje të ngjashme të zgjidhura ndryshe nga Gjykata e Lartë, por kjo e fundit e ka diskriminuar atë duke mbajtur qëndrim të ndryshëm.

27. Gjykata ka pohuar se zbatimi në mënyrë uniforme i ligjit, garantimin e të cilit, në instancë të fundit, Kushtetuta në nenin 141 ia ka ngarkuar në mënyrë të shprehur Gjykatës së Lartë, është një element thelbësor i parimit të barazisë përpara ligjit. Ky i fundit së bashku me parimin e sigurisë juridike ndërlidhen midis tyre me qëllim garantimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë. Kjo do të thotë se individët kanë pritshmëri të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe mund të referohen në vendime gjyqësore të mëparshme për raste të ngjashme, në mënyrë që të parashikojnë efektet juridike të veprimeve ose mosveprimeve të tyre (*shih vendimin nr. 47, datë 11.06.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Po kështu, Gjykata ka mbajtur qëndrimin se, kur kërkuesit kanë pretenduar cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit në lidhje me mënyrën se si gjykatat kanë vendosur në raste të ngjashme, atëherë vlerësimi kushtetues i mënyrës së zgjidhjes së çështjeve të ngjashme nga gjykatat e zakonshme bëhet duke verifikuar rrethanat e rastit konkret. Fakti që gjykatat e zakonshme kanë vendosur ndryshe në një rast të ngjashëm, në vetvete nuk mund të justifikojë *apriori* pretendimet e individit, pasi mënyra e zgjidhjes së çështjes dhe e zbatimit të ligjit është e drejtë e çdo gjykate, për sa kohë çdo çështje konkrete është specifike dhe ka individualitetin e saj, harmonizuar edhe me rrethana, faktorë, motive ose prova gjyqësore, të cilat nuk mund të jenë të njëjta (*shih vendimet nr. 19, datë 21.03.2024; nr. 17, datë 23.03.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Mbi bazën e standardeve të mësipërme, Kolegji vëren se ndër vendimet e referuara nga kërkuesi në ankimin kushtetues individual, vetëm dy prej tyre parashtrohen me rrethana të ngjashme me ato të kërkuesit në drejtim të kohës së paraqitjes së padisë në gjykatë. Megjithatë, ato dy raste, të ngjashme në dukje, nuk janë vendime njësuere, ndaj janë të pamjaftueshme për të krijuar pritshmëri të ligjshme në raport me numrin e lartë të vendimeve të tjera të dhëna nga Gjykata e Lartë, në të cilat është interpretuar Ligji i Shërbimit Civil. Për më tepër, ashtu siç u analizua më sipër, interpretimi i ligjit prej Gjykatës së Lartë në rastin e kërkuesit paraqitet pa gabime faktike dhe ligjore. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se argumentet e kërkuesit janë të pamjaftueshme në nivel kushtetues për të vënë në diskutim parimet e barazisë përpara ligjit dhe të sigurisë juridike, ndaj këto pretendime nuk mund të merren në shqyrtim.

30. Në përfundim, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual i kërkuesit nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.